

KONTRATË DHURIMI E KUOTAVE

Sot më 15/07/2019 në Selinë e Shoqërisë "CCL Albania" Sh.p.k, me adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Emin Duraku" Tiranë, lidhet kjo kontratë Dhurimi të Kuotave mes palëve si më poshtë vijon:

PALA DHURUESE:

1. KOSTA MILLO, I biri I Nikolla-s, lindur më 17.08.1986, në Kavajë, Durrës dhe banues në Rr."Muhamed Gjallesha" 63/2, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me Nr.BD7482573.

PRANUES DHURIMI:


2. AKIL RAJDHO, I biri I Orest-it, lindur me 08.09.1987, në Kavajë, Durrës dhe banues në Rr."Medar Shtylla" 34/1 , Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me Nr.BE6377402.

NENI 1 OBJEKTI

1. Kjo Kontratë ka për objekt dhurimin e 45% të vlerës së kapitalit të shoqërisë, të zotëruara nga Pala Dhuruese e kësaj kontrate, z. Kosta Milo, ortak në Shoqërinë "CCL Albania" Sh.p.k, zoterues i 45 kuotave, me vlerë të përgjithshme 45 .000 lekë, të cilat përfaqësojnë 45% te kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë nominale 1000 lekë secila dhe të gjitha të drejtave që lidhen me to, të cilat ia kalon në shënjë mirënjohje Palës Pranuese. Pala Dhuruese ka vendosur t'ia kalojë këto kuota një prej ortakëve të tjerë të kësaj shoqërie z. Akil Rajdho (Pala Pranuese e Dhurimit në këtë Kontratë).
2. Pala Pranuese e Dhurimit, pranon nga Pala Dhuruese 45% të kuotave që kjo e fundit zotëron, si dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që lindin nga posedimi I kuotave të sipërcituara.

NENI 2 DETYRIMET E PALËS DHURUESE

1. Pala dhuruese deklaron se është zoterues i 45 kuotave, me vlerë të përgjithshme 45.000 lekë, të cilat përfaqësojnë 45% te kapitalit themeltar të shoqërisë "CCL Albania" Sh.p.k, me vlerë nominale 1000 lekë secila dhe zotërues i të gjitha të drejtave që lidhen me to.
2. Pala dhuruese garanton Palën Pranuese të dhurimit, se këto kuota janë të lira nga çdo barrësim dhe detyrim karshi të tretëve dhe për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretët për cënimin e së drejtës së pronësisë se palës pranuese të dhurimit (eviksjon), Pala e Parë është e gatshme dhe i detyruar të paraqitet, vërtetojë e provojë vetë personalisht, me



kërkesën e palës pranuese të dhurimit dhe të cdo personi tjetër të tretë, që pretendon mbi këto kuota, para të gjitha organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave si dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e Palës Pranues të Dhurimit.

NENI 2

Detyrimet e Palës Pranuese

1. Pala Pranuese e Dhurimit, pranon dhe merr në dorëzim kuotat e zotëruara nga Pala Dhuruese.

Neni 3

Detyrime Dypalëshe

1. Palët kontraktuese deklarojnë se të gjitha detyrimet e përshkruara më lart dhe të gjitha ato që burojnë nga kjo kontratë dhurimi janë realizuar prej tyre dhe ata nuk kanë asnjë detyrim të ndërsjelltë midis tyre dhe nuk do të kenë asnjë detyrim në të ardhmen.
2. Palët kontraktuese deklarojnë se kuotat janë marrë në dorëzim nga Pala Pranuese e Dhurimit në gjendjen e përshkruar në brendësi të kësaj kontrate dhe nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me këtë veprim.

NENI 4

PASOJAT TRANZITORE TË KALIMIT TË AKSIONEVE

1. Pala Dhuruese dhe Pala Pranuese janë solidarisht përgjegjës ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kësaj kontrate.
2. Përgjegjësia solidare e palës dhuruese dhe palës pranuese ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kësaj kontrate fillon nga çasti i kalimit të kuotave nëpërmjet nënshkrimit të kontratës dhe përfundon me regjistrimin e këtij kalimi në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.

NENI 5

EFEKTET E KONTRATËS.

1. Kalimi i pronësisë së kuotave nga pala dhuruese tek pala pranuese në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate përfundon me regjistrimin e kësaj kontrate pranë QKR dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" I ndryshuar.



2. Kalimi I Kuotave sipas kësaj kontrate regjistrohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” I ndryshuar.
3. Regjistrimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni ka efekt deklarativ.

NENI 6 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë është hartuar në bazë dhe në zbatim të vullnetit të lirë dhe të pavesuar të palëve të përcaktuara në Krye të kësaj Kontrate.

Kjo kontratë bazohet e përpilohet në përputhje me dispozitat dhe parashikimet e:

1. Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (Titulli II, Kreu III, Neni 761 e vijues).
2. Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
3. Statutit të Shoqërisë “CCL Albania” Sh.p.k, specifikisht Nenit 8 pika ç) e tij.

NENI 7 DISPOZITA TRANZITORE

1. Në çdo rast kjo Kontratë do të interpretohet në bazë të legjislacionit shqiptar.
2. Kontrata hartohet në 3 kopje me vlerë ligjore të njëjtë.
3. Kjo Kontratë u hartua dhe nënshkruhet në selinë e Shoqërisë “CCL Albania” Sh.p.k me adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Emin Duraku” Tiranë.

NENI 8 TË TJERA

1. Për sa u parashikua më sipër palët me vullnetin e tyre të lirë deklarojnë, se do t'i përmbushin me korrektësi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuar në këtë kontratë.
2. Palët e nënshkruajnë këtë kontratë në përputhje me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pavesuar.

PALA DHURUESE

Ilir Mulla
hauha

PALA PRANUESE E DHURIMIT

Akil Raxho
Raxho